




**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
VU644-19-9340-5-3-5/C245  
14 Nr. 1429/19  
Dt. 18.12.2019

## **ANEKS KONTRATË PUNE/SHËRBIMI**

### **Palët kontraktuese :**

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**), dhe
2. NNP “ Wenda “ me seli në Vushtrri, me NRB: 80281714 e Nr. Fiskal: 600203939, të cilën e përfaqëson **z. Kadri Selmani**, në tekstin e mëtejme: **KRYESI I PUNËVE/ SHËRBIMEVE**, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për ekzekutimin e shërbimeve dhe / ose punëve, si në vijim: : **Ndërtimi i fushave sportive, me numër identifikues:**

Prokurimi Nr.	VU644	1	9	93	4	0	5	3	5
Prokurimi Nr.	644	1	9	0	8	2	5	3	5

### **Neni 1 Lënda**

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë : **ekzekutimi i punimeve shtesë të paraqitura gjatë ekzekutimit të punimeve në projektin : “ Ndërtimi i fushave sportive “, në pajtim dhe në sasi si në Specifikimin Teknike pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.**
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit. Afati i fillimit të punëve është menjëherë pas lidhjes së Aneks Kontratës, ndërsa ekzekutimi i punëve dhe / ose shërbimeve duhen të përfundohen në afatin, jo më gjatë se 4 ditë kalendarike pas datës së fillimit të ekzekutimit të Punëve dhe / ose Shërbimeve.
- 1.3 Vendi i ekzekutimit të punimeve është: **fushat sportive sipas Kontratës bazë nr. 919/19 dt. 12.09.2019.**
- 1.4 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

- 2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

### **Neni 3 Çmimi**

- 3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **4.533,09€ ( katërmijpesqindtridhjetetre/09 Euro).**
- 3.2 Mjetet për realizimin e projektit janë siguruar nga fondet e Komunës së Vushtrrisë.

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.3 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

#### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit teknik të Punëve dhe / ose shërbimeve të ekzekutuara të konfirmuara nga Organi Mbikëqyrës. Raporti me shkrim i hartuar dhe nënshkruar nga Organi Mbikëqyrës do të dorëzohet, një kopje Kontraktuesit dhe një kopje Drejtorisë për Prokurim me qëllim të procedimit me pagesat për punimet dhe / ose shërbimet e përfunduara dhe / ose pranuar.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

#### **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

#### **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti respektivisht cilësia e punëve dhe / ose shërbimeve duhet, në të gjitha aspektet, të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

#### **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni, përmes Deklaratës me shkrim, do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të punëve dhe / ose shërbimeve.

#### **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,10% në ditë të vlerës së punëve dhe / ose shërbimeve të pa përfunduara/dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f).

Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

**Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

**Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

**Neni 14 Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.





E hartuar në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

**Për Operatorin Ekonomik:**

**NNP "Wenda" – Vushtrri**

**Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e**

**Vushtrrisë**

<b>Emri:</b>	<b>Kadri Selmani</b>	<b>Emri:</b>	<b>Saranda Cakaj</b>
<b>Pozita:</b>	Pronar	<b>Pozita:</b>	Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	18.12.2019	<b>Data:</b>	18.12.2019
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G


Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, 18, e jo në formatin 0%, 8% apo 18%  
 Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, Po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy decimale pas presjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSH)-€	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
	<b>Ndërtimi i Fushës Sportive në Sh. Fillore "MUSTAF VENHARI"</b>								
1.1	Germimi gjere i dheut me trashesi h mesatare 10-40.0 cm , kategoria e terrenit III, IV dhe V per rrafshimin e terrenit ne vende ndertimin e fushes, materiali i germuar mund te planifikohet sasia e tepert ne deponi , nw kwtw pozicionw wshw pwrshirw edhe punet nw germimn edheut nw fushen sportive nw fshatin Mihalic	m <sup>3</sup>	55.00	1.02	18.00	1.20	55.93	10.07	66.00
1.2	Germimi gjere i dheut me trashesi h mesatare 30.0 cm , kategoria e terrenit III, IV dhe V, dimensionet e parpara per fushë dhe hapsire perçjellese 21.50x40.0 m, materiali i germuar mund te planifikohet sasia e tepert ne deponi	m <sup>3</sup>	12.00	1.02	18.00	1.20	12.20	2.20	14.40
2	Hapia e themeleve me dore me dimensione 50x50x110 cm per punimin e rrethojës së fushës së sportit materiali i germuar mund te planifikohet ose largohet ne deponi, llogarija për copë	Copë	10.00	1.27	18.00	1.50	12.71	2.29	15.00

2.1	Nivelizimi dhe ngjeshja me cilindër vibruës adekuat e sipërfaqes së dhaut pas gërmimit	m <sup>2</sup>	79.80	0.30	18.00	0.35	23.67	4.26	27.93
3	Furnizimi dhe shtrimi i zhavorrit në bazamentin dhe themelet e mureve ansore me fraksion 0-60mm me trashësi 10 cm duke përfshirë edhe ngjeshjen.	m <sup>3</sup>	11.14	3.39	18.00	4.00	37.76	6.80	44.56
3.1	Furnizimi me material dhe betonimi i themeleve shitore të mureve me dimensione 50x70x28 m nga betoni C-25/30 MPa, të kalkulohet edhe armatura konstruktive e themelet, llogaritur për cop të themelet	m <sup>3</sup>	1.76	59.32	18.00	70.00	104.64	18.84	123.48
3.2	Furnizimi me material dhe betonimi i pllakës nënë ulset e binave, në këtë pozicionë të kalkulohet edhe armatura konstruktive eplakës.	m <sup>3</sup>	8.20	101.69	18.00	120.00	833.90	150.10	984.00
3.3	Furnizimi me material dhe betonimi i shkallëve ( ulsete të binave me dimensione h=50cm ; b=70cm ulset e binave, në këtë pozicionë të kalkulohet edhe armatura konstruktive e shkallëve.	m <sup>3</sup>	12.00	101.69	18.00	120.00	1,220.34	219.66	1,440.00
3.4	Furnizimi me material dhe betonimi i themeleve dhe mureve ansore, në këtë pozicionë të kalkulohet edhe armatura konstruktive e themeleve	m <sup>3</sup>	12.00	101.69	18.00	120.00	1,220.34	219.66	1,440.00
3.5	Furnizimi, prerja, saldimi dhe punimi i rrethojës metalike sipas detajit në projekt. Lartësia e rrethojës është H=4.10 m. Në pozicion të përfshihen ankerimet e nevojshme, shtyllat vertikale, horizontale, mbushjen me rriet Ø8 qdo 15 cm të kufizuar me profila L, pllakat lidhëse mbyllesat përfundimtare, ljerëja me një ngjyë baze dhe dy shtresa finale. ngjyra duhet të jetë sipas projektit. Llogritja në m <sup>2</sup> të rrethojës. Verëjtje :shiqo detajin.	m <sup>2</sup>	84.00	3.81	18.00	4.50	320.34	57.66	378.00
<b>TOTALI I PËRGJITHSHEME ME TVSH:</b>							<b>3,841.84</b>	<b>691.53</b>	<b>4,533.37</b>

27.93  
 44.56  
 123.48  
 984.00  
 1,440.00  
 1,440.00  
 378.00  
 4,533.37

# REKAPITULLIMI

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	NNP "WENDA"
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Kadri Selmani
NËNSHKRIMI:	
DATA:	12.12.2019
VULA:	